REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 653,654,669/22
Datë/Datum. 24.11.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSh. nr. 653,654,669/2022

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, dhe nenin 17 paragrafi 3 sipas procesverbalit të bordit të OSHP-së, të datës 30.09.2022, për Amandamentim të Rregullores nr.01/2020, me numër të protokollit 83/2022, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik OE "DATA GISconsultin" sh.p.k., Prishtinë, e datës: 14.11.2022 (protokoll653-22), ankesës OE "Universiteti për Biznes dhe Teknologji Prishtinë - UBT", të datës 14.11.2022 (protokoll 654-22) dhe ankesës së OE " Universiteti për Biznes dhe Teknologji –UBT" të datës: 17.11.2022 (protokoll 669-22), për aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i planit zhvillimor Komunal Fushe Kosovë" me numër të prokurimit:612-22-11782-2-2-1 Nr. të brendshëm: 612 22 056 221, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Fushë Kosovë , Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj - Mexhuani me datën: 23.11.2022, mori këtë:

VENDIM

Hedhet si jo e plotë ankesa OE "DATA GISconsultin" sh.p.k., Prishtinë, e datës 14.11.2022 (protokoll 653-22), ankesa e OE "Universiteti për Biznes dhe Teknologji-UBT", e datës 14.11.2022 (protokoll 654-22) dhe ankesa e OE "Universiteti për Biznes dhe Teknologji-UBT " e datës 17.11.2022 (protokoll 669-22), te parashtruara për aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i planit zhvillimor Komunal Fushe Kosovë" me numër të prokurimit:612-22-11782-2-2-1 Nr. të brendshëm: 612 22 056 221, iniciuar nga (AK) Kuvendi Komunal Fushë Kosovë.

I lejohet autoritetit kontraktues – Kuvendit Komunal Fushë Kosovë , që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i planit zhvillimor Komunal Fushe Kosovë"

me numër të prokurimit:612-22-11782-2-2-1 Nr. të brendshëm: 612 22 056 221 përkitazi me këto ankesa nëse nuk ka ankesë tjetër .

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik të ankesave me datë 14.11.2022, ora 11:20h , tek rubrika e ankesave ka pranuar Letër Standarde kërkesë për sqarimin e tenderit nga OE "DATA GISconsultin" sh.p.k., Prishtinë (protokoll 653/22). Kësaj shkrese OE në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi siç e kërkon neni 111 i LPP-së. OSHP, operatorit ekonomik në fjalë nuk i është drejtuar me ndonjë emali për ti kërkuar plotësim të kësaj shkrese në pajtim me dispozitën e lartcekur nga fakti se në te njëjtën ditë pra me date 14.11.2022 në ora 14:11h, në sistemin e prokurimit tek ankesat figuron se dokumenti i lartcekur është tërhequr nga sistemi elektronik e-prokurimit andaj konsiderohet se OE në fjalë e ka tërhequr ankesën me numër të protokollit 653/2022, të datës 14.11.2022 të orës 11:20h.

Gjithashtu OSHP me datë 14.11.2022 , tek rubrika e ankesave ka pranuar Letër Standarde kërkesë për sqarimin e tenderit nga OE "Universiteti për Biznes dhe Teknologji Prishtinë (protokoll 654/22). Kësaj shkrese OE në fjale nuk I ka bashkangjitur asnjë dëshmi siç e kërkon neni 111 I LPP-së. OSHP I ka dërguar e-mail OE ankues ku e ka njoftuar se i njëjti ka dërguar vetëm një Letër Standarde kërkesë për sqarimin e tenderit dhe nëse dëshiron që te parashtroj ankesë te rregullt duhet te ofroj dëshmi në pajtim me nenin 111 të LPP-së.
I njëjti OE me datën 17.11.2022 në sistemin elektronik te prokurimit rubrika e ankesave ka dorëzuar ankesë ku kjo ankesë në OSHP merr numër te protokollit 669/2022, por OE në fjalë kësaj ankese nuk i ka bashkangjitur as dëshminë e flete pagesës e as dëshminë e kërkesës për rishqyrtim edhe pse menjëherë ishte njoftuar nga OSHP, se ankesa duhet të plotësohet në pajtim me nenin 111 të LPP-së.

Sqarojmë se AK për aktivitetin prokurimit "Hartimi i planit zhvillimor Komunal Fushe Kosovë" me numër të prokurimit:612-22-11782-2-2-1 Nr. të brendshëm: 612 22 056 221, iniciuar nga (AK) Kuvendi Komunal Fushë Kosovë, Njoftimin për kontrate e ka publikuar me datën 26.10.2022 sipas këtij njoftimi afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 16.11.2022.
Në E-prokurim dhe në ankesë të OE nuk figuron kërkesa për rishqyrtim. Kërkesa për rishqyrtim nga OE- ankues nuk është parashtruar gjë që as vendim nga AK nuk ka.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vlerësohet se OE "DATA GISconsultin" sh.p.k., Prishtinë (protokoll 653/22, ka tërhequr nga sistemi e-prokurimit rubrika e ankesave, ankesën me numër te protokollit 653/2022 të datës 14.11.2022 dhe OSHP e aprovon ketë tërheqje të kësaj ankese – shkrese.

Kurse për aneksen e parashtruar nga OE me numër 654/2022 të datës: 14.11.2022 OSHP konstaton se meqë, OE nuk kanë ofruar dëshminë e pagesës së tarifës së ankesës , të përmendur në nenin 118 të LPP-së dhe dëshmitë tjera në pajtim me nenin 111 të këtij neni , edhe për kundër faktit se OSHP, ju ka dërguar email OE ne fjalë duke i sqaruar që ankesa e dërguara për te hyre në shqyrtim nga OSHP duhet te plotësohet në pajtim me nenin 111 të LPP-së, me tarifën e ankesës dhe me shkresat tjera sipas dispozitës se lartcekur , i njëjti operator ekonomik deri me sot datë: 23.11.2022, nuk ka dërguar asnjë përgjigje për plotësim të ankesës –shkresës në fjalë por i njëjti OE me datën 17.11.2022, në sistemin elektronik te e-prokurimit –rubrika e ankesave dërgon formularin standard te ankesës duke mos i bashkangjitur as dëshminë tarifës së ankesës as vendimin në kërkesën për rishqyrtim dhe as dëshmi që i njëjti ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK sipas nenit 108/A të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se ankesa-shkresa e OE " Universiteti për Biznes dhe Teknologji-UBT", e datës 14.11.2022 (protokoll 654-22) dhe ankesa e OE "Universiteti për Biznes dhe Teknologji-UBT " e datës 17.11.2022 (protokoll 669-22), për të hyrë në shqyrtim konform nenit 111 paragrafit 1 pika 9 te LPP-së, ankesat do të duhet të kishin te bashkangjitur një kopje të vendimit të miratuar nga autoriteti kontraktues gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A, dhe në pajtim piken 10 të paragrafit dhe dispozitës se lartcekur ankesat do të duhej të ishin te kompletuara edhe me dëshminë e pagesës së tarifës së ankesës , të përmendur në nenin 118 të këtij ligji.

Po ashtu edhe neni 13 pika 7 dhe 8 e Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020,me numër të protokollit 83/2020, specifikon: Të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP, konform nenit 14 të F03 të legjislacionit dytësor te KRPP-së.

Duke u bazuar ne sqarimet e dhëna si me lart dëshmitë e ofruara nga palët në procedure për rastin konkret OSHP konstaton se ankesat e lartcekura konsiderohet si jo te plota dhe si te tilla nuk hyn në shqyrtim nga OSHP.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP-së

Vjosa Gradinaj Mexhuani

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Kuvendi Komunal Fushë Kosovë

1x1 OE "DATA GISconsultin" sh.p.k., Prishtinë
1x1 Universiteti për Biznes dhe Teknologji Prishtinë
1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së